

VENDIM
Nr. 96, datë 8.6.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MOBIGAS ALBA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, ”Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 50; 22, pika 2, germa “ç” dhe nenit 83, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të neneve 4, pika 1, germa “ç”; 5; 8; 9 pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 10, pikat 1 dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.6.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror,

konstatoi se:

- Shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 723 prot., datë 22.5.2020, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

- Shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k., është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB-së), në datën 3.7.2019, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

- Objekt i veprimtarisë së saj është: Çdo aktivitet në lidhje me shitjen me pakicë dhe shpërndarjen e gazit natyror (CNG/LNG) dhe në masën e lejuar nga ligji, mund gjithashtu të furnizojë me gaz natyror të lëngshëm (LNG) konsumatorët industrial, stacionet e energjisë elektrike, transportin e automjeteve dhe furnizimin e anijeve etj.

Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k., në bazë të nenit 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezulton si më poshtë vijon:

- Dokumentet e parashikuara në nenin 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar.

Mungojnë dokumentet e parashikuara në germën “d” (ii) (Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesore të shoqërisë tregtare nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale). Do t’i kërkohet shoqërisë, që në zbatim të parashikimeve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, të paraqesë në ERE, vërtetim të Gjendjes Gjyqësore për përfaqësuesin e saj me autorizim.

Dokumentet e parashikuara në germën “d” (vi). Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga, ose për aplikantin, për të kryer funksionet, ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore sipas rastit, për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse. Plotësuar pjesërisht. Do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore sipas rastit, për aktivitetet, ushtrimi i të cilëve kryhet me asetet përkatëse.

Dokumentet e parashikuara në germën “e” (ii). Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre viteve të fundit, që paraprijnë paraqitjen e aplikimit. Të pa plotësuar.

Subjekti “MobiGas Alba” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE pasqyrat financiare të audituara, për vitin 2019 (nga data 3.7.2019 në të cilën edhe është regjistruar, deri në mbylljen e vitit ushtrimor). Do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE ato, në përputhje me afatet e parashikuara në njoftimin e publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të datës 27.3.2020.

Dokumentet e parashikuara në germën “e” (v). Vërtetimin e kryerjes së pagesës ndaj ERE-s të tarifës së aplikimit në fuqi, në momentin e paraqitjes së aplikimit. Plotësuar.

- Neni 9, pika 2 (i), (ii), (iii).

i. Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti. Plotësuar.

ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria “MobiGas Alba” sh.p.k. ka bërë me dije (në mënyrë deklarative, pa përcjellë një certifikatë garancie, ku të jenë të dhënat përkatëse për gazin që do të tregtohet), se angazhohet që gazi natyror, i cili do të transportohet dhe shitet nga kompania, do të përmbushë kriteret e cilësisë, duke mbetur brenda specifikimeve minimale sipas të dhënave. Plotësuar pjesërisht.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit. Plotësuar pjesërisht. Në vijim, do t'i kërkohet aplikuesit të paraqesë në ERE dokumentacionin financiar, i cili pasqyron kapitalin financiar të vënë në dispozicion nga shoqëria për qëllime të këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MobiGas Alba” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti